Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike

# Projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Postuar më: 20.05.2020

Ky projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ka për qëllim të përcaktojë bazën ligjore për përdorimin e të dhënave të hapura dhe të drejtën e ripërdorimit për qëllime tregtare ose jo, të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike, me qëllim nxitjen e inovacionit në produkte dhe shërbime.

Ky projektligj, synon transpozimin e Direktivës (BE) 2019/1024 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 20 qershorit 2019 “Mbi të dhënat e hapura dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik”, lidhur me ripërdorimin e informacionit të sektorit publik duke përditësuar kuadrin ligjor me avancimin e teknologjive digjitale duke nxitur më tej inovacionin digjital, veçanërisht sa i përket inteligjencës artificiale.

Përsa më sipër, ftohen grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet e tyre.

**Dokumenta:**

- Projektligji
- Raporti i vleresimit te ndikimit
- Relacioni

## Diskutimet